

**KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË
PARË DHE TË DYTË NË KOLEGJIN UNIVERSITAR "LUARASI",
PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021**

1. Në programet e studimit "Bachelor" në "Financë-Bankë" dhe "Administrim Biznesi" pranohen për t'u regjistruar aplikantët të cilët:

- i. Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë vendit (të ekuivalentuar sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit).
- ii. Plotësojnë kriterin e notës mesatare minimale sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.
- iii. Renditja e aplikantëve do të kryhet duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - a) 80% e notës mesatare aritmetike të shkollës së mesme, përfshirë provimet e maturës shtetërore;
 - b) dhe me 20% mesataren për lëndët e provimit me zgjedhje të maturës shtetërore.

Lëndët me zgjedhje të maturës shtetërore janë si vijon:

- iv. Ekonomi 20%,
- v. Plotësojnë kriteret e tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Në programin e studimit "Bachelor" në "Informatikë Ekonomike" dhe "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" pranohen për t'u regjistruar aplikantët të cilët:

- i. Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë vendit (të ekuivalentuar sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit).
- ii. Plotësojnë kriterin e notës mesatare minimale sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.
- iii. Renditja e aplikantëve do të kryhet duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

- c) 80% e notës mesatare aritmetike të shkollës së mesme, përfshirë provimet e maturës shtetërore;
- d) dhe me 20% mesataren për lëndët e provimeve me zgjedhje të maturës shtetërore.

Lëndët me zgjedhje të maturës shtetërore janë si vijon:

- Gjuhë e huaj.
- iv. Plotësojnë kriteret e tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Në programin e studimit “Bachelor” në “Drejtësi” pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:

- i. Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë vendit (të ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit).
- ii. Plotësojnë kriterin e notës mesatare minimale sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.
- iii. Renditja e aplikantëve do të kryhet duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - e) 80% e notës mesatare aritmetike të shkollës së mesme, përfshirë provimet e maturës shtetërore;
 - f) dhe me 20% mesataren për lëndën me zgjedhje të maturës shtetërore.

Lënda me zgjedhje e maturës shtetërore është si vijon:

- Histori dhe Gjeografi 20%.
- iv. Plotësojnë kriteret e tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. Në programin e studimit Master Shkencor “Banka dhe tregje Financiare”:

- i. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
- ii. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, në Ekonomik me programe të ngjashme me fushën e Ekonomikut, si: Administrim Biznes, Ekonomiks, Marketing, Menaxhim, Financë- Bankë, Kontabilitet, Teknologji Informacioni, Informatikë Ekonomike, Informatikë etj., ose zotërojnë një

diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MASR, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.

5. Master Shkencor “Menaxhim Ekzekutiv”:

- i. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
- ii. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë Bachelor së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, në fushën e Ekonomisë apo me programe studimi të ngjashme me fushat e Ekonomikut, si: Administrim Biznes, Ekonomiks, Marketing, Menaxhim, Financë- Bankë, Kontabilitet, Teknologji Informacioni, Informatikë Ekonomike, Informatikë etj., si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të parë bachelor apo të dytë ose ciklit të tretë të marra nga Institucione të tjera të arsimit të Lartë me programe studimi në fusha të ndryshme nga ato të sipërcituara pa kërkuar plotësim të njohurive formuese (pa kredite për t'u plotësuar).
- iii. Ose vërtetojnë se zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar dhe ekuivalentuar nga MASR, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.

6. Për Masterin Profesional “Menaxhim Sigurimesh”:

- i. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
- ii. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë Bachelor së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, nga Institucione të arsimit të Lartë të njëjta me KU Luarasi, me programe të ngjashme me fushën e Ekonomikut, Teknologjisë së Informacionit, Drejtësisë, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të parë nga Institucione të tjera të arsimit të Lartë me programe në fusha të ndryshme nga ato të sipërcituara pa kërkuar plotësim të njohurive formuese. Në qoftëse zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të jetë e vlerësuar dhe ekuivalentuar më parë nga MASR.

7. Për Masterin Profesional “Marketing dhe Reklama”:

- i. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
- ii. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të Ciklit të Parë, Bachelor së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, në fushën në programeve të ofruara nga Fakultetet Ekonomike, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të nga MAS, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të Ciklit të Dytë ose të Ciklit të Tretë në fushën e Ekonomisë. Në qoftëse zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të jetë e vlerësuar dhe ekuivalentuar më parë nga MASR.

8. Për Masterat Profesional “Financë dhe Menaxhim Risku”, “Kontabilitet”

- i. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
- ii. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, në Ekonomik me programe të ngjashme me fushën e Ekonomikut, si: Administrim Biznes, Ekonomiks, Marketing, Menaxhim, Financë- Bankë, Kontabilitet, Teknologji Informacioni, Informatikë Ekonomike, Informatikë etj., ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MASR, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.

9. Në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Teknologji Informacioni dhe Inovacion”, pranoen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:

- i. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
- ii. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në Informatikë, Teknologji Informacioni, Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Telekomunikacioni, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Inxhinieri Ekonomike, Ekonomik (të gjitha profilet), Matematikë, Inxhinieri Matematike, etj., së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar

jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MASR, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.

- iii. Kanë të drejtën e pranimit vetëm aplikantët nga fushat e mësipërme, njohuritë formuese të të cilëve konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 2/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre (jo më pak se 80 kredite).
- iv. Zotërojnë dëshmi të gjuhës së huaj, niveli B1, mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar, sipas përcaktimit të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

- a) Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;
- b) Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

10. Në programin e studimit “Master Profesional” në “Siguria Kibernetike dhe e Informacionit”, pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:

- i. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
- ii. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor, në Informatikë, Teknologji Informacioni, Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Telekomunikacioni, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Inxhinieri Ekonomike, Ekonomik (të gjitha profilet), Matematikë, Inxhinieri Matematike, etj., së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MASR, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.
- iii. Kanë të drejtën e pranimit vetëm aplikantët nga fushat e mësipërme, njohuritë formuese të të cilëve konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 2/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre (jo më pak se 80 kredite).
- iv. Zotërojnë dëshmi të gjuhës së huaj, në përfundim të studimeve, niveli B1, mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar, sipas përcaktimit të Udhëzimit Nr. 52,

datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

- a) Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;
- b) Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

11. Në programin e studimit “Master i Shkencave” në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:

- a. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
- b. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në Drejtësi apo diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në programe të ngjashme me fushën e Drejtësisë si: Shkenca Politike; Diplomaci; Marrëdhënie Ndërkombëtare, Histori, Bussines Law etj., së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MASR, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.
 - i. Kanë të drejtën e pranimi vetëm aplikantët nga fushat e mësipërme, njohuritë formuese të të cilëve konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 1/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre.
- c. Zotërojnë dëshmi të gjuhës angleze, Niveli B1, mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar, sipas përcaktimit të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

- a. Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;
- b. Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

12. Në programin e studimit “Master i Shkencave” në “E Drejtë Penale” pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:

- a. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
- b. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në Drejtësi apo diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në Shkenca sociale me programe të ngjashme me fushën e Drejtësisë si: Shkenca Politike; Diplomaci; Marrëdhënie Ndërkombëtare, Akademia e Rendit, Akademia e Policisë, Psikologji etj., së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MASR, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.
 - i. Kanë të drejtën e pranimit vetëm aplikantët nga fushat e mësipërme, njohuritë formuese të të cilëve konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 1/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre.
- c. Zotërojnë dëshmi të gjuhës angleze, Niveli B1, mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar, sipas përcaktimit të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

- a. Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;
- b. Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

13. Në programin e studimit “Master Profesional” në “Siguria dhe Rendi Publik” pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:

- a. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
- b. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në Drejtësi apo diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në programe të ngjashme me

fushën e Drejtësisë si: Shkenca Politike; Diplomaci; Marrëdhënie Ndërkombëtare, Akademia e Rendit, Akademia e Policisë, Psikologji, Teknologji Informacioni dhe Inovacioni etj., së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MASR, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.

- i. Kanë të drejtën e pranimit vetëm aplikantët nga fushat e mësipërme, njohuritë formuese të të cilëve konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 1/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre.
- c. Përpara përfundimit të studimeve Master Profesional të mbrojnë provimin e gjuhës angleze, Niveli B1, mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar, sipas përcaktimit të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

- a. Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;
- b. Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës.



Matura Shtetërore 2020
@matura.shteterore

Prof. Dr. Ethem Ruka

KRYETAR I SENATIT